

1. Mother Theresa Association
2. Center for Peace and Tolerance
3. Center for Policies and Advocacy
4. Syri i Vizionit
5. ATTA
6. Kosova Democratic Institute
7. KCIC
8. FOL Movement
9. Mundesia
10. ACTIV

BULETINI TREMUJOR

Nr. 2, SHTATOR - NËNTOR 2013



DnV PËRQENDROHET TEK VOTUESIT E RINJ

11 SHTATOR 2013 - Në kuadër të fushatës së saj për edukim të votuesve, DnV ka filluar organizimin e zgjedhjeve simuluese me nxënësit e shkollave të mesme. Këto aktivitete zhvillohen në bashkëpunim me KKZ-të nëpër komuna të Kosovës dhe kanë për qëllim që të njoftojnë votuesit e rinj me konceptin e zgjedhjeve dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në këto zgjedhje. Simulimet zgjedhore luajnë një rol të rëndësishëm në rritjen e pjesëmarrjes së votuesve të rinj në proceset zgjedhore. Simulimet zgjedhore do të mbahen në Pejë, Gjiilan, Prishtinë, Graçanicë, Gjakovë, Mitrovicë e Veriut, Prizren, Lipjan, Pejë, Skenderaj dhe Han të Elezit.

TË VERBËRIT NJOFTOHEN ME PROCESIN ZGJEDHOR

18 SHTATOR 2013 - Me moton “Unë votoj vet”, Demokracia në Veprim ka organizuar një tryezë me personat e verbër dhe me te pamë të dobësuar te komunës së Prishtinës. Në këtë tryezë janë diskutuar të drejtat që gëzojnë personat me nevoja të veçanta, në veçanti personat e verbër, në procesin zgjedhor. Ata u njoftuan se KQZ edhe këtë vit do iu vë në dispozicion shabllonët në shkrimin Brail për të ju mundësuar personave të verbër të votojnë në mënyrë të pavarur. Duke folur për procedurën e votimit për personat e verbër ose me pamë të dobësuar, Shqipe Pantina, anëtare e bordit të Demokracisë në Veprim, i informoi pjesëmarrësit që në çdo Qendër Votimi do të ketë shabllonë në shkrimin Brail dhe se të njëjtit duhet të kërkohen nga kryesuesit e vendvotimeve. Demokracia në Veprim në vazhdimësi është duke organizuar tryeza të tilla me kategori të ndryshme të personave me nevoja të veçanta për të i njoftuar ata me procesin zgjedhor dhe për t'i nxitur të marrin pjesë në Zgjedhje.



BULETINI TREMUJOR

Nr. 2, SHTATOR - NËNTOR 2013

DNV PREZANTON PLANIN DHE PËRGADITJET PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE

2 TETOR 2013 – DnV ka mbajtur një konferencë për media ku është prezantuar plani dhe përgatitjet që i ka bërë ky rrjet për vëzhgimin e zgjedhjeve lokale të 03 nëntorit 2013. Petrit Zogaj, anëtar i bordit të DnV-së ka folur për përgatitjet që janë bërë deri më tani, dhe aktivitetet e mbështetura nga USAID përmes NDI. Në emër të DnV, ai u ka bërë thirrje institucioneve, siç është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të angazhohet maksimalisht, në mënyrë që qytetarët e Kosovës të shohin zgjedhje të lira, demokratike dhe të ndershme.



DNV PREZANTON RAPORTIN E PARË JAVOR NGA MONITORIMI I FUSHATËS SË ZGJEDHJEVE DHE MEDIAVE

12 TETOR 2013 – DnV mbajti konferencë për media për të prezantuar raportin e parë monitorues nga java e parë e fushatës zgjedhore në kuadër të Zgjedhjeve Lokale 2013. Ismet Kryeziu, udhëheqës i Koalicionit Demokracia në Veprim ka thënë se vëzhguesit afatgjatë të DnV-së kanë vëzhguar nga afër 217 takime publike të subjekteve politike dhe vlerësoi se në këto takime pjesëmarrja e qytetarëve ka arritur rreth 40.000 qytetarë apo rreth 2.35 % e trupit elektoral, bazuar në trendet e mëhershme kjo tregon një inferioritet të qytetarëve për të përcjellë nga afër fushatat zgjedhore. Sipas Kryeziut, fushata zgjedhore përgjithësisht është zhvilluar e qetë dhe pa ndonjë incident kritik gjatë kësaj jave. Megjithatë, ekspozimi i armëve në tubime si mbrojtje për personat publik është vërejtur se po shkakton iritim tek qytetarët.

DEKLARATË PRELIMINARE LIDHUR ME TË GJETURAT DHE MBARËVAJTJEN E PROCESIT TË VOTIMIT

3 NËNTOR 2013 - Bazuar në të dhënat e vëzhguesve të DnV-së, të drejtën për të hedhur votën e tyre në kutitë e votimit në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës e kanë shfrytëzuar **803.359** votues apo **48,83%** nga gjithsej **1.779.357** sa ishin të regjistruar në listën përfundimtare të votuesve. Përkundër disa parregullsive të vogla, ka qenë një proces zgjedhor i qetë, i rregullt dhe demokratik, me përjashtim të veriut të vendit.

